

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Kushtimi i plotë / *et-Tebettul* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَتَبَّئِلْ إِلَيْهِ تَبْتِيلاً"

“Dhe kushtoj Atij me një kushtim të plotë.” (el-Muzzemmil, 8)

*Tebettul* nënkupton devocion të plotë.<sup>1</sup> Të thënë e Allahut në ajet “ ... Atij ...” është ftesë për një shkëputje tërësore. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është shkëputja e plotë nga interesimi për vetveten dhe nga të parët e botës me frikë, me shpresë apo me çfarëdo shqetësimi. Kjo realizohet:

- Duke shkëputur shpresën (për këtë botë) me anë të kënaqësisë<sup>2</sup>
- Duke shkëputur frikën (nga kjo botë) me anë të nënshtimit.
- Duke shpërfillur të gjitha shqetësimet (e kësaj bote) ndërsa shikon të vërtetën.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Kontradiktë, apo mesatare? Muslimi përcolli nga Se'id ibn-Musejjib: “Dëgjova Sa'din (Ibn ebi Wekaas) të thoshte se qëndrimet e Uthman ibn Maz'un rreth beqarisë së përhershme / celibatit (*tebettul*) u refuzuan nga i Dërguari ﷺ. Sikur ai ﷺ të jepte leje për këtë, do t'i tridhnim vetët tona.” Ky hadith nuk bie ndesh me ajetin në fjalë, por tregon se i njëjti emër nganjëherë mund të përdoret për koncepte të ndryshme, të cilat sheriati mund t'i pranojë apo t'i refuzojë. Njësi matëse e pagabuar janë vetëm mësimet nga jeta e të Dërguarit ﷺ dhe e Sahabëve. *Tebettul* në kuptimin e vetmisë dhe shmangies nga komuniteti, në shumicën e rasteve, është e ndaluar apo e papëlqyeshme. Ndonjë formë e kësaj mund të jenë të përshtatshme për njerëz të caktuar, për shkak të prijeve që kanë apo për shkak të paaftësisë së tyre për t'iu përmbajtur parimeve ndërsa përballen me realitetet sfiduese.

<sup>2</sup> Nëse ti je i kënaqur me atë çfarë të jep Ai, nuk do ta humbësh dinjitetin apo moralin në ndjekjen e kësaj bote.

<sup>3</sup> E vërteta është se, të gjitha krijesat dhe veprimet që i bëjnë ato, janë nën kontrollin e plotë të Krijuesit të tyre. Përse ti duhet të shqetësohesh për këtë botë, kur kushtimi

Niveli i dytë është shkëputja e plotë nga vetvetja:

- Duke ia shmangur pasioneve
- Duke përqaftuar puhizën e intimitetit ngushëllues (*uns*) me Allahun
- Duke parë dritat e zbulimit<sup>4</sup>

Niveli i tretë është kushtimi i plotë ndaj triumfit:

- Duke përmirësuar ndershmërinë<sup>5</sup>
- Duke u zhytur në angazhimin për arritjen e synimit
- Duke parë fillesat e bashkimit (*xhem*)<sup>6</sup>

---

yt ndaj Tij të mjafton. Kjo nuk është një thirrje për *tewaakul* / neglizhencë, por për *tewekkul* të vërtetë, ku personi merr masat ashtu siç e urdhëron Allahu dhe më pas mbështetet krejtësisht te Ai. Edhe nëse personi është i paaftë për të marrë masa, prapë duhet të mbështetet krejtësisht te Allahu, sepse këto masa s'janë gjë tjetër veçse shkaqe, ndërsa Ai është shkaktari kryesor.

<sup>4</sup> Atëherë kur Ai ta zbulon shtegun drejt stacioneve (shkallëve) të ndryshme, t'i zbulon të metat e vetes sate (nepsit) dhe, çka është më e rëndësishme, ta zbulon kuptimin e emrave dhe cilësive të Tij.

<sup>5</sup> Duke rishqyrtuar korrektësinë dhe sineritetin tënd dhe duke dëlir ndershmërinë prej njollave të ndershmërisë.

<sup>6</sup> *Xhem'* / جمع (unitet, bashkim, shoqërim me Allahun). Koncepti i saktë i bashkimit (që është i ndryshëm nga besimi i *hulûl* dhe *ittihaad*, që përkthehet si uniteti me hyjnoren dhe prania në të) nënkupton përputhjen e plotë të vullnetit tënd me të Tijin, në mënyrë që të njësohesh me Të në synim. Kjo po ashtu i referohet gjendjes së të qenët me Allahun, i shkëputur nga ndjekjet dhe dëshirat e kësaj bote. Çka është më e rëndësishme, kjo i referohet zbatimit të unitetit dhe njësisë së të Vërtetit, të Përjetshmit, të Parit, Zanafillës, Burimit, Shkaktarit kryesor, të Vetëmjaftueshmit; duke parë se gjithçka tjetër veç Tij është e vërtetë, për shkakun se Ai është Krijuesi i vërtetë, dhe njëherësh (gjithçka) varet nga vullneti i Tij dhe është manifestim i vullnetit të Tij. Krahas kësaj, të gjitha ngjarjet në univers po ashtu janë të vërteta, por edhe ato s'janë gjë tjetër veçse manifestime të emrave të Tij.

*Ferk* / فرق (ndarje, dallim, ndryshim, varietet) është e kundërta e *xhem'*, kur kjo nënkupton ndarje prej Tij apo *teferruk* / تفرق (devijim, shpërqendrim). Në këtë rast, kjo është dukshëm negative. Mirëpo, kur kjo nënkupton dallim (si në rastin kur personi shikon shumësinë e krijesave dhe të dukurive të krijuara), s'është negative, nëse nuk shkakton *teferruk*.

Personi duhet të jetë i vetëdijshëm për *xhem'* dhe *ferk* në kuptimin se duhet të shohë shumësinë nga këndvështrimi i tij, meqë ajo çfarë Allahu do nga ne, ndryshon sipas rrethanave. Kështu, personi duhet të dallojë urdhrin e ndalimin nga caktimet e Tij që Ai pëlqen - siç është të besuarit e besimtarëve – dhe nga caktimet që Ai nuk pëlqen, siç është refuzimi i mosbesimtarëve. Është thelbësore të vëresh *ferk* (varietetet, dallimet, ndryshimet, shumësinë) në këto gjëra ndërsa e pranon unitetin e origjinës,

---

Bërësin, Pronarin, Kontrolluesin, dhe punon drejt *xhem'* (bashkimit) tënd me Të. Të parët e këtyre dallimeve do të ta mundësojë kalimin në nivelin më të lartë të robërimit (*ubûdijeh*) ndaj Allahut, ku synimi yt kryesor nuk do të jetë ajo çfarë ti do nga Zoti yt, por çfarë Ai do nga ti. Atëherë, intimiteti ngushëllues (*uns*) që ti ndien gjatë dhikrit (kujtimit të Allahut) nuk do të të parandalojë nga shkuarja në xhami për t'u falur me xhemat, apo që t'i shërbesh mysafirit, familjes, etj. Pra, ti bën krejt këtë, ngaqë kjo është çfarë Ai do nga ti në këto rrethana.